



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 872/1 prot.

Tiranë, më 18.11.2024

VENDIM
Nr. 70, datë 18.11.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 98, DATË 30.11.2023

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 98, datë 30.11.2023, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin nr. 645, datë 16.06.2023, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar mbikëqyrjen në institucionin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimit nr. 98, datë 30.11.2023, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe paralajmërimin e institucionit

për të rregulluar parregullsitë e konstatuara”, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, Komisioneri, me shkresën nr. 156/3 prot., datë 04.09.2023, ka kërkuar nga institucioni informacion mbi ecurinë e procesit dhe veprimet e ndërmarra në përmbushje të detyrimeve të vendosura në dispozitivin e këtij vendimi.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, përmes shkresës nr. 18273/3 prot., datë 01.03.2024, *“Kthim përgjigje”*, institucioni i Ministrisë së Financave ka informuar Komisionerin për masat e marra.

Në kushtet kur, përgjigjja e institucionit nuk ishte ezauruese, Komisioneri, në datën 16 shtator 2024, i është drejtuar me anë të komunikimit elektronik Departamentit të Administratës Publike, duke kërkuar një informacion për të gjitha ministritë që i janë nënshtruar procesit të mbikëqyrjes me objekt vlerësimet e punës të nëpunësve civilë. Ky i fundit, me e-mailin e datës 14 shtator 2024, i është përgjigjur kërkesës së Komisionerit, duke parashtruar situatën e ecurisë së procesit në këto institucione.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 98, datë 30.11.2023, si dhe bazuar në përgjigjen e institucionit dhe njësisë përgjegjëse (DAP), lidhur me veprimet administrative të kryera prej tyre, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Ministrisë së Financave paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë paligjshmëritë.

Në pikat 2 – 5 të vendimit objekt i këtij verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet e ngarkuara nga ligji me detyra të posaçme në administrimin e shërbimit civil gjatë procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë (*zyrtarët raportues, kundërfirmues dhe autorizues*) të marrin masat si më poshtë:

- Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të marrë masa për administrimin e procesit duke bashkëpunuar me zyrtarët e vlerësimit.
- Nëpunësit civil të cilët janë personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji për kryerjen e vlerësimit dhe kanë rolet e zyrtarit raportues, kundërfirmues dhe autorizues të kryejnë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë që mbikëqyren në mënyrë të drejtëpërdrejtë prej tyre sipas linjës së hierarkisë.
- Në rastin e vlerësimeve të pjesshme për shkak të largimit të zyrtarëve që duhet të bëjnë vlerësimin, zyrtari raportues zëvendësues që përmbyll procesin, të bëjë vlerësimin përfundimtar për gjithë periudhën 6-mujore të vlerësimit;
- Plotësimin e të gjitha ndarjeve të formularit të vlerësimit që janë konstatuar të paplotësuara;

- Përmbylljen e procedurës së vlerësimit për periudhën korrik-dhjetor 2022, për të gjitha rastet e evidentuara në raportin përfundimtar.

Referuar përmbajtjes së shkresës së sipërcituar të Ministrisë së Financave, nga ana e këtij institucioni relatohet se janë marrë masat administrative që lidhen me procesin e vlerësimit periodik të nëpunësve civilë, të cilat janë reflektuar në vlerësimet e 6 mujorit të dytë vitit 2023.

Sa më sipër konfirmohet edhe nga njësia përgjegjëse (DAP) në e-mailin e datës 14.10.2024, dërguar Komisionerit, ku theksohet se detyrat e lëna për vlerësimet e nëpunësve civilë deri në nivelin e mesëm drejtues janë zbatuar referuar përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi.

Në lidhje me rekomandimin për hartimin e një plani trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislativ i shërbimit civil, nga përmbajtja e shkresës së MIE rezulton se njësia e burimeve njerëzore në këtë institucion i ka komunikuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), nevojat për trajnime sipas kërkesave të përcjella nga drejtoritë/sectorët e këtij institucioni.

Në pikat 6 dhe 7 të dispozitivit të vendimit, Komisioneri ka kërkuar respektivisht nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit dhe Departamenti i Administratës Publike të drejtojnë procesin e vlerësimit të të gjithë nëpunësve civilë, anëtarë të TND-së, në mënyrë që të përmbillet saktë procedura e vlerësimit të rezultave në punë.

Referuar komunikimit elektronik të datës 14.10.2024, DAP ka informuar Komisionerin se për sa i takon vlerësimeve për TND-në, ato janë në fazë shqyrtimi dhe diskutimi së bashku me ministrinë e linjës për finalizimin e këtij procesi.

Për sa u përket më sipër, vlerësoj se, nga ana e institucionit janë zbatuar detyrat e lëna në pikat 2-5 të dispozitivit të vendimit.

Ndërsa sa i takon vlerësimeve për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, nisur nga kompleksiteti i veprimeve që duhet të kryhen në këtë rast, si dhe nga organizmi specifik që duhet t'i kryejë këto veprime, bazuar edhe në pikën 4, të nenit 36, të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, (e ndryshuar), propozojmë që pikat 6 dhe 7 të vendimit të jenë objekt i kontrollit gjatë mbikëqyrjes së radhës në subjekt ose mbikëqyrjes së orientuar që ushtrohet në vijimësi gjatë gjithë vitit, ku informacioni mbi ecurinë e procesit dhe realizimin e detyrës nga ana Ministrisë së Financave t'i përcillet inspektorit që e mbikëqyr këtë subjekt.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së*

Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, i ndryshuar, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 98, datë 30.11.2023, të Komisionerit, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike për zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil gjatë realizimit të procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë në aparatin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*, për pikat 2 – 5 të dispozitivit të këtij vendimi, për shkak të rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Financave, duke zbatuar detyrat e lëna në pikat 2 – 5 të dispozitivit të Vendimit nr. 98, datë 30.11.2023.
3. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në përfundim të procesit të vlerësimeve për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, të njoftojë Komisionerin në lidhje me realizimin e detyrave të lëna në pikat 6 dhe 7, të vendimit 98/2023, të Komisionerit.
4. Për këtë vendim të njoftohet njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha